



FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT ALBANIAN DEVELOPMENT FUND

Tiranë, më 15/01/2010

Njoftim për shtyp

Miratohet buxheti vjetor për investimet e Fondit Shqiptar të Zhvillimit

Sot u organizua mbledhja e Këshillit Drejtues të Fondit Shqiptar të Zhvillimit. Në qendër të kësaj mbledhje ishte miratimi i buxhetit vjetor për investimet që do të realizohen nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit për vitin 2010. Buxheti i aprovuar këtë vit është në masën 3,929 milionë leke.

Investimet kryesore për këtë vit do të realizohen në kuadër të projekteve "Përmirësimi i rrugëve dytësore e lokale", Projekti "Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale", projekti i "Ujësjellësve Rurale", si edhe investime të Qeverisë Shqiptare.

Pjesa më e madhe e investimeve do të kryen në kuadër të projektit "Përmirësimi i rrugëve dytësore e lokale në Shqipëri", projekt që po zbatohet prej tre vjetësh. Ky projekt ka si qëllim përmirësimin e aksesit në shërbimet bazë dhe mundësitë e zhvillimit ekonomik për popullsinë rurale.

Deri me sot në këtë projekt janë angazhuar përveç Qeverisë Shqiptare edhe Banka Botërore, OFID, Banka e Këshillit të Evropës për Zhvillim në një vlerë prej 97 milion USD. Gjate vitit 2010, parashikohet që të jenë rehabilituar apo të jenë në rikonstruksion 340 km rrugë.

Buxheti i këtij viti karakterizohet nga një rritje e konsiderueshme e investimeve, duke ulur ndjeshëm kostot operative për realizimin e tyre.

Për vitin 2010 këtij projekti do t'i bashkëngjiten edhe financimet e BERZH, BEI, IDB dhe programi IPA, që do të plotësojnë buxhetin total të projektit me një fond prej 238 milion USD duke e çuar shumën totale të projektit në 335 milionë USD.

Gjate vitit 2010 do të fillojnë gjithashtu investimet në Projektin e "Ujësjellësve Rurale", që financohet nga KfW, në të cilin do të rehabilitohen apo ndërtohen 28 skema të ujësjellësve rurale në 50 fshatra të tre qarqeve të veriut të Shqipërisë.

Një projekt tjetër i rëndësishëm që përfundon këtë vit fazën e tij të investimeve është projekti "Punët në komunitet III" financuar nga Banka e Këshillit të Evropës për Zhvillim në vlerën 14.38 milion Euro. Ky projekt ka si qëllim të nxisë zhvillimin social ekonomik të zonave rurale të vendit, të cilat kanë potenciale të zhvillimit ekonomik, veçanërisht në turizëm. Në projekt janë përfshirë 16 komuna, të cilat janë të shpërndara gjeografikisht, dhe kanë tipare të veçanta të turizmit.

Fondi Shqiptar i Zhvillimit është një institucion që nxit zhvillimin ekonomik dhe social të qëndrueshëm, të balancuar dhe koheziv, në nivel rajonal dhe lokal, në mbështetje të politikave shtetërore të zhvillimit.

Fondi Shqiptar i Zhvillimit është krijuar si agjenci autonome implementuese e "Projektit të Lehtësimit të Varfërisë Rurale" në fillim të vitit 1993, mbi bazën e një marrëveshje midis Qeverisë Shqiptare dhe Bankës Botërore date 09. 01. 1993

Me datë 11 Maj, 2009, Kuvendi i Shqipërisë miratoi Ligjin Nr 10130 date 11. 05. 2009, "Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit", që i përcakton këtij institucioni një status të veçantë ligjor.

Për informacion me te detajuar mbi FSHZH-ne mund te vizitoni faqen e internetit www.albaniandf.org ose te na kontaktoni ne adresën:

Rruga "Sami Frasheri", Nr. 10, Tirane

Tel: +355 4 2235 597/8

Tel/Fax: +355 4 2234 885

adf@albaniandf.org